

ÇËSHTJE TË PËRKTHIMIT TË VEPRËS SË KADARESË NË GJUHËN ANGLEZE ISSUES OF KADARE TRANSLATION WORK IN ENGLISH

VIOLA ISUFAJ

Departamenti i Letërsisë, Fakulteti i Histori Filologjisë, Universiteti i Tiranës
Email: violaisufaj@hotmail.com

Hyrje

Profili i shkrimtarit Ismail Kadare në botën anglishtfolëse është i pjesshëm. Përkthimet në gjuhën frënge përfshijnë pothuaj gjithë veprën e tij dhe janë më profesionale. Ato janë kryer pothuajse të gjitha nga Jusuf Vrioni, pas vdekjes së të cilit, Tedi Papavrami, u parapëlqye si pasardhës i tij. Nga përkthyesit në gjuhën angleze, (përmes frëngjishtes së Jusuf Vrionit dhe Tedi Papavramit), David Bellos-i duket se ia ka dalë të transmetojë kontekstin shqiptar dhe poetikën e Kadaresë në botën anglishtfolëse. Komunikimi ndërkulturor e ndërkontekstual është një problem që haset dendur në përkthimet e veprave letrare. Cili është atëherë, roli i madh që luan përkthyesi dhe, në këtë rast, vetë autori, për ta bërë të transplantueshme një vepër në kulturën e një marrësi global?

Metodat: Krahasimi i tekstit në anglisht me tekstin në origjinal; nxjerrja e njërive të cilat nuk përkrijnë me origjinalin, ose që me vështirësi transmetojnë një pjesë të veçanësisë së kontekstit shqiptar; nxjerrja e njërive dhe e ndërtimeve të cilat në shqipe karakterizohen nga veçanësia përdoruese krahasuar me traktatet normative në fuqi; studimi i përfaqësimit të gegërishtes brenda kësaj veçanësie dhe krahasimi me gjegjëset e tyre në gjuhën angleze.

Rezultatet: Hulumtimi mbi çështje të koklavitura gjuhësore dhe kulturore të hasura në original dhe studimi i “zgjdhjes” së këtyre çështjeve në përkthimin në gjuhën frënge dhe atë angleze të romanit *Lulet e ftohta të marsit*, hulumtimi mbi çështje të depërtimit në shtresat kuptimore të tekstit, të depërtimit në realitetin shqiptar; çështje të bukurtingëllimit, të leksikut, morfologjisë, sintaksës, fjalëformimit, të neologjizmave dhe të figuracionit- ruajtja në përkthim e atyre veçorive, pra, që përbëjnë stilin kadarean, por po ashtu, dhe reflektimi i stilit dhe i ndjeshmerisë së përkthyesit gjatë një transmetimi të tillë të dyfishtë.

Përcaktimi i çështjeve që mbeten “të pazgjithshme”.

Diskutimi

Tashmë të shumëta janë përkthimet jo vetëm nga origjinali, por dhe nga ndonjë gjuhë tjetër në të cilën vepra është përkthyer. Normalisht një vepër (letrare) duhet të përkthehet nga gjuha origjinale meqënëse çdo gjuhë lidhet me një shoqëri, qytetërim, kulturë e mendësi të dhënë, meqënëse ajo përcakton mënyrën e të parit të botës nga një bashkësi e caktuar njerëzish dhe meqë në këtë vepër të shkruar ekziston një stil i papërsëritshëm, një figuracion artistik dhe një raport i caktuar midis të thënës dhe të nënkuptuarës (Tupja, 2004: 32).

Kur marrim një vepër të përkthyer një herë dhe bëjmë përkthim pas përkthimi, do të priremi t’i qartësojmë dhe më shumë disa gjëra, pra do ta çekuilibrojmë edhe më raportin midis të thënës dhe të nënkuptuarës, çka mund të çënojë frymën e vetë veprës (Tupja, 2004: 33).

Përkthimi i veprës *Lulet e ftohta të marsit* në gjuhën angleze përmes frëngjishtes është kryer nga David Bellos-i, i cili fillimisht ka ngurrur ta bëjë këtë, pikërisht pasi vepra mund të dëmtohej shumë për shkak të një transmetimi të tillë të dyfishtë.

Por gjuha shqipe në të cilën është shkruar një vepër madhore si ajo e Ismail Kadaresë, është një gjuhë e rrallë për marrësin e huaj.

Çështje të tekstit dhe të intertekstit

Në çdo përkthim letrar apo pragmatik, duhet të mbahen parasysh dy parametra tejet të rëndësishëm: konteksti dhe situata. I pari është gjuhësor, e dyta jashtëgjuhësore. Konteksti përbëhet nga vetë fjalët e një fjalie me kuptimin e tyre leksikor dhe gramatikor. Kurse situata është kuadri ku kuptimi i kësaj fjalie bëhet edhe më i qartë për lexuesin apo dëgjuesin. (Tupja, 2004: 41).

Cilësia e një përkthimi qëndron dhe në atë ecjake të vazhdueshme që përkthyesit i duhet të bëjnë midis kontekstit gjuhësor dhe situatës jashtëgjuhësore ku ndërkallet teksti për t'u përkthyer (Tupja, 2004: 45).

Studimi i të folurit në tërë variueshmërinë e funksioneve të tij, analiza e mjeteve, mënyrave e efekteve në përfaqësimin e një ngjarjeje të caktuar, mbetet një nga angazhimet themelore të gjuhësisë pastrukturaliste (Rrokaj, 2007: 167).

Me mjeshtërinë e tij të pazakontë autori në romanin *Lulet e ftohta të marsit* fokuson në brendësi të tij një rrjet marrëdhëniesh ku mpleksen harmonikisht elemente të tilla si: motivi i martesës së vajzës me gjarprin, marrja e gjakut, ringjallja e kanunit, karakteristikat më tipike të viteve e tranzicionit dhe të totalitarizmit etj., të cilat parqiten përmes një realizmi poetik dhe shqoqërohen me mendime origjinale për realitetin dëshpërues shqiptar.

Analiza e raporteve tekst-intertekst në një vepër letrare është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me Temën, Fabulën dhe Motivin, si dhe me marrëdhëniet që ekzistojnë midis tyre (Rrokaj, 2007: 130).

Me intertekst kuptohen, përgjithësisht, raportet që çdo tekst, gojor a i shkruar vendos me tekstet e tjera në rrafshet e ndërkohësisë dhe të bashkëkohësisë, brenda së njëjtës kulturë a kulturave të ndryshme (Rrokaj, 2007: 129).

ndër funksionet anësore të intertekstit mund të përmendim ato që lidhen me shprehjen e universit kulturor të autorit, në arritjen e pikëtakimeve me lexuesin brenda këtij universi, ose vendosja e parametrave hapësinorë, kohorë e shoqërorë për aktualizimin referencial të narracionit. (Rrokaj, 2007: 132)

Motivi i ringjalljes së Kanunit

Duke qenë se është një gjuhë çdo gjuhë lidhet me një shoqëri, qytetërim, kulturë e mendësi të dhënë, meqënëse ajo përcakton një këndvështri origjinal të realitetit; pra po të bëjmë përkthim pas përkthimi, detyrimisht i largohemi dhe më shumë këtij raporti, meqë përkthyesi i parë i është larguar tashmë. Nga ana tjetër dihet që çdo përkthyes ka prirje t'i qartësojë disa të dhëna të origjinalit, që kanë të bëjnë sidomos me realitetin e tij socio-kulturor, në menyrë që lexuesi t'i kuptojë ato sa më mirë, sidomos kur vepra që përkthehet i përket një qytetërimi shumë të largët në kohë apo në hapësirë, pra të ndryshëm nga ai i lexuesit për të cilin përkthehet. Kështu që përkthyesi detyrimisht ndërton një raport të ri midis të thënës e të nënkuptuarës, që privilegjon të parën (Tupja, 2004: 33).

Në romanin *Lulet e ftohta të marsit* kemi mbi 20 njësi: fjalë, togfjalësha, fjali thirrmore, formulime, përtëritje fjalësh të vjetra të cilat i referohen së njëjtës dukuri: ringjalljes së Kanunit. Janë bërë përpjekje nga përkthyesi për përkthimin e tyre, por gjithsesi një dukuri aq specifike që karakterizon shqiptarët e vendosur në veri zor se mund të transmetojë thelbin e vet: tmerrin dhe madhësinë në një tjetër shoqëri njerëzore, ku kjo dukuri është thuarje e panjohur. Nuk është e lehtë të kapërcehen vështirësitë që paraqet të kuptuarit e kësaj dukurie socialkulturore tipike për Shqipërinë në një përkthim pa shënime poshtë faqes. Më poshtë kemi disa "formula" e njësi të tjera që kanë të bëjnë me "ringjalljen e gjuhës së vjetër", së bashku me "ringjalljen e kanunit".

If your family has anything to do with a blood feud (f. 73)-

... është në gjak (f.76)

who've cloistered themselves in their kulla, like they used to?-(f. 76)-

të mbyllur në shtëpi, të ngujuar (f.78)

the book of the Blood (f.76)-Libri i Gjakut (f.76)

who still has a blood debt and who hasn't; it even lays down cases where there is just a half-blood still to pay off (f. 76) -

kush e ka shlyer...kush ka shkuar gjakhupës... (f.79)

he was shot as he came (f.110)...-kanë shtirë mbi ... (f.110)

And a kulla, or Tower of Refuge of the highland folk (f. 89)-

dhe për kullat e malësorëve (f. 90)

Angelin of the Ukaj hath slain Marian of the Shkreli- f. 112- (dhënë në shkronja korsive në tekstin në anglisht si një formulë)- Angjelini i Ukajve shtiu mbi Marianin e Shkrelëve

Lord, what a shambles you have left us with, Marian Shkreli! (f.119) -

Mjeri unë për ty o Marian Shkreli

Dorëras (f.113) -e papërkthyer, shkruar në shkronja korsive-dorëras (f.1130)

Koha e diktaturës dhe koha e tranzicionit

Nga ana kuptimore interteksti me funksion qëndror a anësor shpreh një kondensim kuptimor të pazakontë nëpërmjet veprimit të ligjit të ekonomisë gjuhësore. Kur tekste të ndërkallura që kanë hyrë në djepin kulturor të një bashkësie të caktuar, vetëm sa citohen në një vepër, në mbështetje të argumentit në fjalë, shkarkojnë mbi të gjithë ngarkesën kuptimore që kanë në vetvete. (Rrokaj, 2007: 133)

Njësitë e renditura më poshtë janë kryesisht lidhje të veçanta sintagmatike, të cilat në një kontekst të caktuar: në vitet e totalitarizmit apo të tranzicionit,

shenjonin një domethënie të veçantë duke u bërë kondensuese të një kuptimi më të gjerë dhe më tipik nga ai që mund të bartë kuptimi i tyre në përkthimin në gjuhën angleze. Duke qenë se shkarkesa kuptimore e këtyre fjalëve bëhet tejet e vështirë në gjuhën angleze, vërehet se disa herë ky problem është zgjidhur duke e ekonomizuar përdorimin e fjalëve nëpërmjet një përgjdhjeje shumë të kujdesshme nga ana e përkthyesit, e herë të tjera duke përdorur perifrasis, a sqarime të hollësishtme.

the present state of affairs (f.3) -*asaj ç'po ndodhte përreth*

in the early days of the new era (f.39)- *me fillimin e demokracisë* (f.44)

Communist years (f.71)- *viteve të diktaturës* (f.74)

got into...an aged Russian-made all terrain vehicle originally leased to the ministry of interior and then handed to the Arts Center after the fall of the old regime (f.89)- *një Gaz i vjetër i degës së Brendshme* (f.90)

The Kalashnikov rifle (f.96)- *kallashi* (f.97)

the use of explosives-hedhja në erë me tritol (f.970)

beacon of democracy (f.119)- *pishtar i demokracisë* (f.118)

killer (f.116) -*dorëra* (f.116)

"In that funeral land of Spain" (f.119)- *në atë të zezën Spanjë* (f.1180 (në shqipe të kujton menjëherë balladën e Ago Ymerit)

Një nga dukuritë e shumëta që karakterizoi periudhën e tranzicionit në vendin tonë është dhe huazimi i fjalëve, shprehjeve dhe i disa strukturave gramatikore e më pak sintaksore nga gjuhët e huaja: nga italishtja dhe sidomos nga gjuha angleze.

Kemi të bëjmë me dukurinë e interferencës, me të cilën kuptohet kalimi i një elementi të sistemit të gjuhës A, në sistemin e gjuhës B. (Rrokaj, 2007: 120).

Kjo dukuri që ka karakterizuar kontekstin shqiptar nga vitet 90' deri më sot mbetet krejt e pandjeshme për marrësin global, pasi nuk i bëhet dot e njohur atij gjatë përkthimit të romanit *Lulet e ftohta të marsit*.

Në situatën e varrimit të Marian Shkrelit, një punonjës i shtëpisë së kulturës, i cili hapte shfaqjet ose bënte rolin e kllounit, me zë të ngjitur nga ngashërimi, ndërsa po e mbulonin arkivolin me dhe thirri "Okej, Marian!"

Kuptimi i kësaj britme në fakt mund të merrej si përqeshje e të vdekurit, së pari sepse sepse Tom Kola punonte si klloun. Së dyti, fjala "okej" karakterizonte leksikun e Marian Shkrelit, dhe çnatyron fjalorin e shqipes.

Shkurtaj thekson se "Fjalët e huaja të panevojshme, që aq shpesh i përdorin intelektualët, shtetarët dhe sidomos gazetatat, janë shprehje e një imitimi të pamirë

dhe të një përluljeje të kritikueshme. (Rrokaj, 2007: 125).

Efekti i kësaj dukurie është i pandjeshëm në gjuhën angleze pasi nuk është dhënë ndonjë sqarim se fjala "okej" në varrimin e Marian Shkrelit u përdor në gjuhën angleze. Në shqip nuk është thënë "mirë, Marian", sikur të thuhej "pra, lamtumirë, Marian".

(*in a voice strangled by emotion,"Okay, Marian"*- f.119)

E njëjta situatë vërehet në letrën e shqetësuar që vajza i ka lënë Markut në f. 100 të librit në shqip :

"Ungji erdhi sot. Ende s'kuptohet asgjë. I love you."

Në gjuhën angleze është bërë përpjekje që të kuptohet se fraza është thënë në gjuhë të huaj duke përshtatur "I love you" në gjuhën frënge.

"My uncle got here today. Nothing is quite sorted out yet. Je t'embrasse". (f 99)

Në këtë kontekst diçka më në fund, transmetohet. Sikurse thekson studiuesi J. Thomai "Në këtë dhjetëvjeçar të fundit, ... shumëkush ka nisur ta ndiejë frazën e mbushur me fjalë të huaja si shenjë e një kulture të lartë dhe frazën shqipe si shenjë të një gjendjeje të kapërcyer (Rrokaj, 2007: 124).

Me ironi therrëse do të shprehet akademiku Qosja: "Jemi turrur të hyjmë në Evropë duke përdorur sa më shumë fjalë evropiane, por duke harruar se në Evropë nuk hyhet duke humbur identitetin gjuhësor kombëtar. (Rrokaj, 2007: 124)

Problemi qëndron në faktin se gjatë përkthimit është përdorur një frazë në frëngjishte, mirëpo, pikërisht në dhjetëvjeçarin e fundit huazimet nga frëngjishtja ishin tepër të rralla, shumë më të rralla se më parë, ndërsa interferencat nga anglishtja ishin dhe janë dominuese. Përhapja e anglishtes në komunikimin e sotëm lidhet pa dyshim, me epërsinë ekonomike të SHBA-së në tregun botëror... politikës ndërkombëtare, lidhet faktorin psikologjik e sociologjik (Rrokaj, 2007: 117).

Tek individë të ndryshëm është krijuar paragjykimi sikur fjala e gjuhës amtare nuk tingëllon, sikur nuk e thotë atë që kërkohet, prandaj nxitojnë turravrap ta zëvendësojnë atë me fjalën e huaj, me bindjen se kjo e fundit ka diçka të veçantë, se na qenka më e ëmbël (Rrokaj, 2007: 125).

Mbeten të papërkthyer pjesë të tjera të ligjëratës si pashirrrma *Për besë!* f. 113, duke lënë pa realizuar specifikimin në aktin kumtimor ; këto elemente janë pjesë përbërëse e strategjisë së folësit për realizimin e komunikimit.

Toponimia dhe emërtime të tjera

Një nga çështjet më të koklavitura është dhe pamundësia për të përcuar ashpërsinë e relievit verior dhe peisazhit tipit shqiptar, që është pjesë e qënësishë shqiptare. Një nga mënyrat e tipizimit të peisazhit në

funkcion të krijimit të imazhit të mjedisit verior shqiptar është dhe përdorimi i toponimeve-çka i lehtëson përfytyrimin marrësit shqiptar.

Studiuesi Anton Nikë Berisha citon Camajn në funksion të shprehjes së individualitetit krijues dhe imagjinatës krijuese. (kur krahason poezinë gojore me atë të shkruar)

“Të vjetrit tonë, kur tregojshin këso gojdhana tue ba me gisht kah mali apo lugaja, shkurt, kah vendi i ndodhjes, e kishin ma të lehtë të jenë të përpikët në paraqitjen e tyre. Fjala e gjallë mandej që del prej goje depërton ma lehtë në mend e në zemër se sa ajo e qitun ndër shkroja mbi letër” (Berisha, 2000: 28).

Le të marrim për shembull Bjeshkët (e Nëmuna)-mjedis tipik i Malësisë së Veriut; i përkthyer “mountain” nuk specifikon-është thjesht mal, si të gjithë malet e tjera. Raste të tjera të ngjashme:

Up in these mountains (f.43) –*në këto bjeshkë* (f.43)

Mountain Springs (f.35)–*Krojet e epërme*

Tepelen Gorge (f.47)–*Gryka e Tepelenës* (f.52)

the Castle of Orosh (f.79)–*kulla e Oroshit*(f. 80)

Dugagjin (f.79)

TheAccursed Mountains (f.89) - *Bjeshkët e Nëmuna* (f.900)

But then tribes that the Romans called “Slaves” poured down into the North, into the great Plain of Arbëria, and that seemed an extra reason to strengthen the authority of the old Kanun. (f.21)

High Quarter (f.113) –*Lagjia e Epërme* (f.113)

Black Rock (f.114) –*Zgripi i Keq* (f. 113)

village square-logu i katundit (f.28)

Leksiku i kadaresë dhe stili

Çdo lexues, sadopak i njohur me letërsinë e Kadaresë, do të dallonte çfarëdo shkrim të tij, edhe në mungesë të emrit të autorit. Treguesi i parë është gjuha dhe stili i tij (Çausi, 2002: 139).

Në artin e tij lexohen lehtë parapëlqimet për disa mjete gjuhësore e stilistikore, për shkallën dhe mënyrën e përdorimit të tyre (Çausi, 2002: 140).

Kadareja ka meritë në:

rigjallërimin e fjalëve dhe strukturave dialektore a të folmeve

në krijimin e fjalëve me devijim klase

në shqipërimin e fjalëve të huaja me prejardhje të largët

4. – në krijimin e fjalëve të prejardhura

Gjithë ky thesar fjalësh e strukturash është shumë pak ose aspak i ndjeshëm gjatë një transmetimi të dyfishtë. Kjo anë e veçanësisë së stilit të Kadaresë nuk gjen shprehje në gjuhën angleze pasi disa herë kemi të bëjmë me kalke nga gjuhët e huaja, herë me shqipërimi nga gjuhët e huaja, ndërsa neologjizmat e

krijuara duke shfrytëzuar potencialin e shqipes do të ishin jonormative në sistemin të gjuhës angleze.

-Po ashtu, gjuha që përdor Ismail Kadareja karakterizohet nga një bashkësi fjalësh, të cilat kanë mospërputhje drejtshkrimore midis fjalëve të nxjerra dhe fjalorëve, siç është për shembull fjala *zgafellë* (f. 145), por, po ashtu, mjaft nga njësitë që përbëjnë leksikon e parapëlqyer të Kadaresë ekzistojnë në fjalorin e shqipes, por në vepër kanë kuptime dhe valenca të reja. P.sh. emri *rizë-a*, në fjalor shpreh kuptimet: a-peshqir për të fshirë fytyrën, buzët etj., b.-pëlhurë, zakonisht e qëndisur, që vënë gratë në kokë. etj.... Në tekst bëhet fjalë për një perde (plastike) f.146. Në gjuhën angleze është e përkthyer “curtain” (f. 109)-çka nuk sjell asgjë të re në leksikon e gjuhës angleze dhe nuk kryen funksionin që kryen në shqipe duke mos qenë njësi me kuptim tjetër nga ai që ka fjalori i gjuhës angleze. Emra të tjerë janë: *skajim-i*, *frushullimë*; por po ashtu kemi foljet: *veton*, *shfaq*, *thua se*; kemi deftorët: *kësi*, *këso*, etj.

-Disa njësi të motivuara që nuk janë në fjalorin e Gjuhës Shqipe po ashtu nuk mund të krijojnë tek marrësi i huaj efektin që krijojnë gjatë aktit të receiptimit tek lexuesi shqiptar. I tillë është emri: *zgavrin/ë-a* vjen që nga emri “zgavër” me prapashtesën zvogëluese-inë sipas modelit rrug-inë; i tillë është edhe emri *trandje*.

-Fjalë të krijuara a të rigjallëruara nga autori të cilat nuk gjejnë dot gjegjësen e tyre në gjuhën angleze janë dhe formimet onomatopeike p.sh.: *kërkëllitje/a* është një formim anomatopeik i ndërtuar sipas foljes “kërkëllit” me prapashtesën-je për analogji me shëtit-je, gëlltit-je; formime të tjera janë: *vrundullimë*, (suddenly the door swings open (f.60)–dera hapet me vrundullima (f.64), *llapashitje*, *çu-çu-çu-ja*, etj Ndalemi tek disa formime të tjera tipike për ligjërimin e këtij autori, të cilat, si risi dhe veçanësi të stilit të Kadaresë, janë krejt të pandjeshme në përkthimin në gjuhën angleze:

Mbiemri *i fundbotshëm* (f. 26). Kemi të bëjmë me një formim parasintetik. Në fjalor nuk gjendet as forma i botshëm, as kompozita fundbotë. Këtu, me sa duket, kemi të bëjmë me sintetizëm të sintagmës frazeologjike “fundi i botës”. Si model fjalëformues, shqipja ka fjalën *i përbotshëm*.

Ndajfolja *pikëllueshëm* (f. 29) Në fjalor nuk del si mbiemër, por është mbiemri prejpjesor “i pikëlluar”. Vjen prej pjesores geqe që kryesisht shërben për ndërtimin e mbiemrave të këtij tipi. Në këtë rast sistemi i shqipes nuk e përjashton ndërtimin e një mbiemri, prej të cilit, me konversion, përftohet ndajfolja. Në mungesë vepron analogjia fjalëformuese. Kuptimi i sa është “në mënyrë të...” ose “me pikëllim”.

Kemi të bëjmë, pra me një ndajfolje mënyre. Ndajfolje të tjera:

Kujdesshëm (f.32) Ndajfolja e mënyrës është ndërtuar me konversion prej mbiemrit “*i kujdesshëm*”, i cili gjendet në fjalor dhe shpreh kuptimin “*në mënyrë të...*” ose “*me kujdes*”.

Ngutshëm (f. 33)- në fjalor kemi mbiemrin “*i ngutur*”. Kemi të bëjmë me një ndajfolje mënyre të formuar prej mbiemrit “ngut” (mund të diskutohet edhe forma foljore vetvete “ngutem”) dhe ka kuptimin “në mënyrë të...” ose “me ngut”.

Shembuj më të hollësishëm gjenden më poshtë (gjejmë të renditura fjalët e krijuara me devijim klase, fjalëve të huaja të shqipëruara dhe fjalët të prejardhura a kompozita të krijuara nga autori).

Fjalësi me (ue)shëm

hearttrending old tunes- Muzika e pikëllueshme

(f.29)-*carefully-kujdesshëm* (përkim)

(f.101) *faster and faster-ngutshëm* (f.101)

(f.101) *at vertiginous speed-marramendshëm* (f.101)

Toward Dante’s Inferno-dantealigershëm (f.101)

(f.8) *She laughs a pink laugh-qeshte trandafilshëm*

(f.116) *Mark said, looking as forlorn as ever-thoshte përumbshëm* (f.115)

exuded an air of euphoria(f.88)-*fërgëllontë mallëngjyeshëm* (f.89)

(f.122) *skuqnin verbueshëm-e papërkthyer*

(f.113) *great attention-vëmendshëm* (f.73); (f.76)

Fjalësi me “najë”

pubic hair(f.5) –*leshnajë*

(f.39) *rumor, vivified over the weekend-thashemthemnaja e këndellur* (f.44)

(f.48) *of the bay window-qelqanjë* 53

(f.49) *So much murderous criminality-gjithë ajo vjedhnajë*

(f.49) *the sea of dreams-gjithnajë* (f.54)

(f.65) *an alien idea that had come to him from some other world-ardhur nga një tjetër gjithkahnajë* (f.68)

(f.116)

Bay window-qelqanaja (f.115)

(f.93) *hole-gërmajë*

Fjalësi me -ishte (ë)

beaches and seaside (f.55) - *Ranishte* (f. 59)

reed bed (f.102)- *kallamishjtja* (f.101)

discreet disguise (f.86) -*tinëzisht* (f.87)

Të tjera

riza (kur u hiqet riza) - 1.*veil* (when the veil is lifted)-2. *curtain* (f.109)

waiter (f.75)-*kafetar* (f. 77)

somber (f.20)–*zymtare*

Ceiling (f.42) -*qjellzana*

Shops(f. 42) -*tregtizat*

Sodomists (f.46)-*bythësat* (f.50)

tumbling fall (f.52)- *shkapërdredhja* (f.56)

prior (f.58)-*i kryehershëm*

mortal (f.60)- *vdekëtar* (f.63)

lead-swinging (f.62)-*i kotsëkotshtëm* (f.66)

cloak and dagger men (f.63) -*midisësit* (f.66)

bisexual (f.63)-*deledashë* (f.66)

the lunatics (f.63)-*hënëmarrokët*

Dealers in every kind of hocuspocus (f.63)-

ndryshkaheqësit e prangave (f.66)

after its indeterminate absence (f.64) -*pas mungesës së dokohshme*

having lost its old habits (f.64) - *i çmësuar me botën*

for voracity (f.64)- *si gropshqar* (f.68)

Newcomer (f.76)-*ardhacak*

sleeping pill (f.77)-*zgjumth* (f.79)

noisy customers (f.86)-*zhurmëtarët* (f.87)

wiff (f.87) -*fthoma*

cave cave cave(f.90)-*zgafella*

passion (f.92)-*zjarrmia*; *hillside* (f.92) -*shkarrzinës*

the man who propped up the bar (f.102) -(f.102) *bjerrakohësi*

serchlights, with its roaring boilers (f.103) -*tymtarë që lëshonin avull* (f.103)

solitary and cold (f.103) -*i kundradiellt*

version (f.104)-*motërzim* (f.104)

a scarlet rug (f.95)-*flokëse ngjyrë vishnje* (f.96)

filth and madness (f.95)-*bëzhdilet e marritë* (f.96)

snow (f.123)-*borima*

zhurmëri/së njerëzore (f.111)- *gossip* (f.1110)

This ancestral sentence (f.112)- *e kryehershme* (f.112)

reeling danse (f.125)-*valle trillane*(f.123)

in a kind of haughty despair (f.84)-*funddëshpërimi mbretëror*

Distant noise (f.84)-*zhaurimë*) 85

Coffin (f.114)-*arkëmortin* (f.113) *message* (f.112) – *kumt*

put his leg over the balustrade (f.107)-*kapërceu thurimën e ballkonit* (f.107)

he made as sharp about-turn (f.108)- *u kthye vrulltaz* (f.108)

out of the buried passages and clefts (f.112) -*drejt e nga zgafellat* (f.112)

do you think the boss really (f.115)–*përnjimend* (f.114)

in what shape it was held to exist (f.54)- *ku ishte skajuar, në ç’trajtë gjëllonte*

Rubbed out (f.54) -*bjerrur* (f.58) *Sip* (f.55)- *Gjerb* (f.59)

To stop himself from falling into the pit-për të mos u humneruar përsëri (f.105)

Përdorimi i dialektit

Gjuha që përdor Ismail Kadareja është një letrariste dydialektore po të krahasohet, fjala bie, me prozën e Camajt përsa i përket elementit gegë (Rrokaj, 2007: 145). Ismail Kadareja, siç theksuam më lart, ka meritë

në rigjallërimin e fjalëve dhe strukturave dialektore-një dukuri, gjithashtu e pandjeshme në përkthimin në gjuhën angleze përmes frëngjishtes.

“Whatever it is”- (f.13) çkado ...

What did you say, father? (f.13)-Çka the, Baba?

There are even more fearsome things (f.14)...-ka edhe më zi

But let us come (f.42)-po ani - e papërkthyer (f.42)

what’s happened to him, then? (f.110) -hë, pra ç’paska ndodhë? (f.110)

Loja e fjalëve

Thuhet gati proverbalisht se “shënimi në fund të faqes është turpi i përkthyesit”. Sipas disave kjo tregon ose paaftësinë e përkthyesit për t’i gjetur një barazvlerëse një fjale në tekstin burimor ose paturpësinë e tij për t’i shpjeguar lexuesit gjëra a dukuri tipike të një shoqërie a epoke tjetër, ndërkohë që lexuesi nuk është më njeri i paditur. Ka raste kur shënime janë të pashmangshme, sidomos kur ka lojëra fjalësh ose aluzione historike të cilat duhen sqaruar në mënyrë që lexuesi i veprës së përkthyer t’i kuptojë e t’i shijojë tërësisht ato (Tupja, 2004: 81)

Meqë nuk është përkthyer *i pavjedhshëm-i pavdekshëm* (f.84) nuk përkthehet, i humbet efekti i lojës së fjalëve. Për këtë nuk është vënë asnjë shënim në fund të faqes.

Konkluzionet

Në procesin e një transmetimi të dyfishtë siç është përkthimi i romanit *Lulet e ftohta të marsit* në gjuhën angleze përmes frëngjishtes, spikat vështirësia në përcimin e dukurive tipike të realitetit shqiptar të viteve të tranzicionit pas rrëzimit të diktaturës. Disa terma që shenjojnë-dukuri tipizuese shqiptare, por shumë pak ose aspak të njohura për një marrës global, janë emërtuar njëllon në gjuhën anglese për shkak të të përmbajtjes unike të tyre p.sh *Kanun, dorëras* etj.

Shpesh janë dhënë shpjegime përmes përdorimit të kllapave, ose zgjerimit të fjalisë, e herë të tjera ka qenë i pamundur transmetimi i shpërsisë, egërsisë, virgjinitetit, që karakterizon mjedisin shqiptar të veriut, duke qenë së lexuesi i huaj nuk e njeh toponiminë shqiptare.

Mjaft ndërlikim paraqet përkthimi i lojës së fjalëve (ndonjëherë është anashkuar) dhe shumë i pandjeshëm mbetet në gjuhën angleze thesari me neologjizma e rigjallërime fjalësh të vjetra e dialektalizmash, figuracioni dhe strukturat që përcaktojnë, në fakt, stilin e Kadaresë.

Megjithatë, David Bellos ka arritur të na japë në gjuhën angleze ngjyrat e errëta e të pajeta, zymtësinë dhe pesimizmin për një tokë që e braktisën perënditë, për një mars, që siç thotë Frederik Reshpja, nuk ishte mars, por ca lule të ftohta, të rreme.

Bibliografia

ÇAUSHI, Tefik (2002), *Kadareja përmes pasqyrave*,

Onufri, Tiranë.

KADARE, Ismail (2000), *Froides fleurs d’avril*, Artheme Fayard, Paris.

KADARE, Ismail (2002), *Lulet e ftohta të marsit*, Onufri, Tiranë.

KADARE, Ismail (2002), *Spring flowers, spring frost*, Arcade Publishing, New York.

RROKAJ, Shezai (2007), *Çështje të gjuhës shqipe*, Albatros, Tiranë.

SHKURTAJ, Gjovalin (2008), *Si të shkruajmë shqip*, Toena, Tiranë.

THOMAI, Jani (1999), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Shblu, Tiranë.

TUPJA, Edmond (2002), *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri, Tiranë.

TUPJA, Edmond (2004), *Pro Translatore*, Ombra GVG, Tiranë.